



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## RAPORT MONITORIMI

# ZBATIMI I KUADRIT LIGJOR MBI OFRIMIN E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

# 2022-2023



WWW.AHC.ORG.AL

ME MBËSHTETJEN FINANCIARE TË



Ky raport është përgatitur në kuadër të nismës “*Jo Korrupsionit, Po Demokracisë*”, i cili zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe në asnjë rast nuk reflekton apo përfaqëson domosdoshmërisht mendimin apo qëndrimin e Ambasadës Suedeze.

Përgatiti Raportin Studimor:

***Prof.Dr.Assoc. Nadia Rusi , Eksperte e jashtme Ligjore***

Kontribuan në rishikimin dhe redaktimin:

***Z. Njazi Jaho, Këshilltar Ligjor, KShH***

***Znj. Ardita Kolmarku, Drejtuese e Klinikës së Ligjit/Menaxhere Projektesh, KShH***

***Znj. Teuta Pataj, Asistente Projektesh/Paraligjore, KShH***

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

**Autor: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit**

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

**Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania**

**Kutia Postare nr.1752; Tel: 04 2233671; Cel: 0694075732;**

**E-mail: [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al) ; Web site: [www.ahc.org.al](http://www.ahc.org.al)**

Tabela e Përmbajtjes	
<b>LISTA E SHKURTIMEVE:</b> .....	2
<b>Përmbledhje Ekzekutive</b> .....	3
<b>1. Hyrje</b> .....	7
1.1 Konteksti, metodologjia dhe qëllimi i monitorimit .....	8
1.2 Kujt i drejtohet raporti i monitorimit? .....	9
1.3 Metodologjia për hartimin e raporti të monitorimit: .....	9
1.4 Kufizime të raportit .....	10
<b>II. Rezultatet e monitorimit të ofrimit të shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore nga Qendrat e Ndhmës Juridike Falas</b> .....	10
2.1 Mbi strukturën organizative dhe logjistike të Qendrave të Ndhmës Juridike Falas. ....	10
2.2 Mbi veprimtarinë e Qendrave të Ndhmës Juridike .....	13
2.3 Bashkëpunimi i Qendrave me organet e tjera në nivel vendor.....	15
2.4 Lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për të përfituar Ndhmën Juridike Falas ....	15
2.5 Informimi i qytetarëve mbi shërbimin e ndihmës juridike dhe rruajtja e konfidencialitetit.....	16
2.6 E drejta për ankesë dhe vlerësimi i shërbimit nga ana e qytetarëve.....	17
<b>3.Ofrimi i shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore nga Organizatat Jofitimprurëse</b> .....	17
3.1 Procedura e autorizimit dhe financimi i OJF nga MD.....	18
3.2 Marrëdhënia e OJF-ve me DNJF dhe konsultimi i buxhetit vjetor për Ndhmën Juridike falas .....	20
3.3 Vështirësitë lidhur me aksesin e kategorive në nevojë në shërbimet e ndihmës juridike falas.....	20
<b>4. Ofrimi i shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore nga Klinikat e Ligjit në Universitete.</b> ....	20
<b>5. Perceptimi i qytetarëve mbi shërbimin e ndihmës juridike parësore: Gjetje nga pyetësorët me qytetarët</b> .....	22
<b>6. REKOMANDIME</b> .....	27
6.1 Lidhur me ofrimin e shërbimit nga Qendrat e Ndhmës Juridike Parësore KShH: .....	27
6.2 Lidhur me ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore nga Organizatat Jofitimprurëse: .....	28
6.3 Lidhur me ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore nga Klinikat e Ligjit: .....	28

LISTA E SHKURTIMEVE:

NJF	Ndihma Juridike Falas
MD	Ministria e Drejtësisë
KShH	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
NJP	Ndihma Juridike Parësore
ADC	Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
QNJF	Qendra të Ndihmës Juridike Falas

## Përmbledhje Ekzekutive

Nëpërmjet këtij Raporti Monitorimi, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) vijon të ofrojë ekspertizën e tij modeste në informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi nivelin e garantimit të respektimit të ligjit nr. 111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti" në 8 Bashki të vendit. Ky raport i hartuar në kuadër të nismës "Jo Korrupsionit, Po Demokracisë" të mbështetur financiarisht nga Qeveria Suedeze, thekson rëndësinë e ndihmës juridike parësore si një instrument kyç për garantimin e aksesit në drejtësi dhe drejtësisë sociale për qytetarët pa dallim, si dhe synon të sugjerojë hapa konkretë për të përmirësuar sistemin aktual në Shqipëri.

Në aspektin metodologjik, raporti është bazuar në mbledhjen dhe analizën statistikore e analitike të të dhënave parësore dhe dytësore, përfshirë analiën e kuadrit ligjor në fuqi duke identifikuar nevojën për amendime përmirësuese, realizimin e intervistave të standartizuara me punonjësit e qendrave të ndihmës juridike, organizata jofitimprurëse që ofrojnë NJF dhe Klinikat e Ligjit pranë Universiteteve. Duke konsideruar nevojën e analizës së situatës në dy këndvështrime, anketime të anonimizuara u realizuan me rreth 485 qytetarë të vendosur në 8 Bashki të vendit, me synim adresimin e përceptimeve të tyre si konsumatorë të drejtpërdrejtë të ndihmës juridike falas.

Të dhënat e grumbulluara, nëpërmjet metodologjisë së sipërcituar, treguan se ka një nivel të mirë të ndërgjegjësimin e informimit të qytetarëve të vendosur në qendrat e Bashkive dhe zonat urbane të vendit mbi funksionalitetin, kriteret e procedurat që duhen ndjekur për përfitimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore. Megjithatë, vijnë të jenë evidente sfida në lidhje me aksesin e qytetarëve dhe cilësinë e shërbimit të ofruar në disa qytete të vendit. Pjesa më e madhe e qytetarëve të anketuar referojnë se janë të kënaqur me nivelin dhe cilësinë e shërbimit ligjor që ju është ofruar, por ka ende nevojë për përmirësime në infrastrukturë, trajnimin vazhdues e periodik të stafit dhe nxitjen e fuqizimin e bashkëpunimit ndër-institucional në rang lokal.

Në raport me të dhënat e identifikuar në monitorimet e mëhershme të KShH-së<sup>1</sup>, përgjatë periudhës së monitorimit 2022-2023, vërehen përmirësime, por ende evidentohet një hendek gjeografik në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore. Banorët e zonave rurale dhe të thella të vendosur vijnë të përballen me sfida në aksesimin e këtyre shërbimeve. Mungesa e burimeve financiare të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha nevojat e shërbimit të ndihmës juridike parësore mund të ketë ndikuar në cilësinë dhe në mbulimin gjeografik të shërbimit.

Përpjekjet e DNJF dhe ofruesve të shërbimeve të ndihmës parësore falas në nivel lokal vlerësohen pozitive, pasi që rreth 77.9 % e qytetarëve të anketuar rezultojnë se ishin të informuar mbi funksionimin e shërbimeve të ndihmës ligjore falas. Përpos këtyre të dhënave statistikore premtuese, KShH nxit marrjen e masave të vazhdueshme me synim përfshirjen në fushata

---

<sup>1</sup> [https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/01/RAPORT-MONITORIMI\\_-Ndihma-Juridike-Librashd-Kukes-Himare.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/01/RAPORT-MONITORIMI_-Ndihma-Juridike-Librashd-Kukes-Himare.pdf)  
<https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/07/Mbi-ngritjen-dhe-funksionimin-e-aktor%C3%ABve-p%C3%ABrgjegj%C3%ABs-t%C3%AB-ofrimin-t%C3%AB-ndihm%C3%ABs-juridike-par%C3%ABsore.pdf>  
[https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/12/Raport-Ndihma-Juridike-per-publikim\\_-Komiteti-Shqiptar-i-Helsinkit.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/12/Raport-Ndihma-Juridike-per-publikim_-Komiteti-Shqiptar-i-Helsinkit.pdf)  
[https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2017/04/Raport\\_ndihma\\_juridike\\_falas-shkurt-2012.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2017/04/Raport_ndihma_juridike_falas-shkurt-2012.pdf)

informuese e ndërgjegjësuere të kategorive vulnerabël e të marginalizuara të shoqërisë, me fokus të veçantë ata të vendosur në zonat rurale të vendit.

Qendrat e Ndhmës Juridike Falas të monitoruara janë vendosur kryesisht pranë gjykatave për të lehtësuar aksesin e qytetarëve. Megjithatë, përpos masave të marra ende ka sfida në lidhje me hapësirën dhe aksesueshmërinë nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Vështirësi hasin dhe qytetarët me aftësi të kufizuara në shikim dhe dëgjim për të përfituar nga shërbimet ligjore falas. Pas përmbjlljes së disa prej projekteve mbështetëse nga komuniteti i donatorëve, një pjesë e qendrave kaluan nën administrimin e MD, duke passjellë reduktimin e numrit të punonjësve në Qendra nga 2 në 1. Punonjësit aktualisht në funksion pranë qendrave ngrenë si vështirësi efektet që ka sjellë ky përgjysmim, në realizimin e aktiviteteve informuese në terren dhe njëkohësisht ofrimin e shërbimeve ligjore falas ndaj qytetarëve që paraqiten pranë ambientit të qendrës.

Nga analiza e buxhetit të shtetit, sa i përket zërave të miratuar për ndihmën juridike falas është vërejtur një rritje e tij, por pesha e këtij buxheti në raport me buxhetin total të Ministrisë së Drejtësisë është më pak se 1%. KShH vlerëson pozitivisht planifikimin në terma buxhetore të fondeve të dedikuara për ofrimin e shërbimit të NJF për gratë dhe vajzat në nevojë. Megjithatë, konsiderohet i nevojshëm planifikimi i fondeve buxhetore të veçanta edhe për kategori të tjera vulnerabël si: viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, të miturit etj.

Punonjësit ofruer të shërbimeve të ndihmës juridike parësore referojnë si vështirësi mungesën e kapaciteteve të tyre për të suportuar persona me aftësi të kufizuara në shikim dhe dëgjim, në rastin e paraqitjes së tyre pranë zyrave pa kujdestarë. Përpos mbështetjes së ofruar nga OSBE ndaj DNJF përgjatë vitit 2023, ende mbetet në proces finalizimi i Manualit të dedikuar mbi ndihmën juridike në gjuhën brail. Pavarësisht këtij manuali ndihmues, KShH vlerëson se masa konkrete duhen ndërmarrë për të përshtatur edhe formatet e formularëve që duhen plotësuar domosdoshmërisht nga ana e kësaj kategorie.

Përgjatë viteve 2022-2023, punonjësit e Qendrave të Ndhmës Juridike janë përfshirë në trajnime të vazhdueshme e periodike. Rritja e kapaciteteve të punonjësve vlerësojmë se ndikon pozitivisht në rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimit të NJF, duke afirmuar vëmendjen e shtuar që DNJF dhe MD kanë ndaj këtij shërbimi. Megjithatë, forcimi i urave të bashkëpunimit me ASPA-n, mendojmë se do të përmirësonte realizimin e këtyre trajnimeve në përputhje me interesat dhe problematikat ligjore më të hasura në raport me bashkëveprimin me qytetarët.

Nga analiza e të dhënave statistikore që Qendrat raportojnë pranë DNJF, rezulton se ato trajtojnë mesatarisht rreth 25 raste në muaj, ku në pjesën më të madhe mbizotërojnë problematikat ligjore të qytetarëve mbi çështje administrative dhe civile/familjare. Intervistimi dhe bashkëbisedimi me përfaqësuesit e këtyre qendrave nxori në pah krijimin e partneritetit të kënaqshëm mes tyre dhe organeve në nivel lokal. KShH nxit nevojën për ruajtjen e zhvillimin e këtij partneriteti kundrejt krijimit të një mekanizmi referues të mirëfilltë të rasteve dhe identifikimit të praktikave pozitive, vështirësive dhe pengesave, me synim gjetjen e zgjidhjeve adekuate.

Nga ana e organizatave joqeveritare, punonjësve të qendrave dhe qytetarëve të anketuar u ngrit me shqetësim burokracia dhe procedurat e tejzgjatura që kërkohen të ndërmerren me synim përmbjlljen e suksesshme të aplikimit nga ana e qytetarëve për të përfituar ndihmë juridike

parësore falas. Vlerësohet pozitivisht roli proaktiv që kanë luajtur punonjësit e qendrave për të interpretuar kuadrin ligjor dhe nënligjor në mënyrë të zgjeruar, në fleksibilitet të interesit më të lartë të qytetarëve. Megjithatë, KShH e shikon sfiduese procedurën e grumbullimit të dokumentacionit, veçanërisht për individët me mjete të kufizuara ekonomike ose pjesëtarë të grupeve të marginalizuara të shoqërisë. Ndër vështirësitë radhiten: mungesë informacioni ose vonesa në procedurën e aksesimit e dokumentacionit të nevojshëm përmes portalit elektronik qeveritar E-Albania, si dhe paaftësia paguese e kërkuësve kundrejt shërbimeve/dokumentave të cilat disponohen online nga portali me pagesë.

Edhe pse në fokus të këtij procesi monitorimi është ndihma juridike parësore falas, KShH vëren mungesë të unifikimit të trajtimit të praktikës së dokumentacionit që grumbullohet nga qytetari, ndërmjet dy formave të ofrimit të shërbimeve ligjore të garantuara nga shteti. Më konkretisht, Gjykata gjatë shqyrtimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore bazohet vetëm në vlerësimin e të ardhurave sipas ligjit, duke mos konsideruar elementët prevalencë si provueshmëria mbi të ardhurat, pasuritë dhe shpenzime e qytetarëve.

Përgjatë periudhës së monitorimit 2022-2023, MD ka autorizuar 15 OJF për ofrimin e shërbimeve të NJF. Në mazhorancë, 10 prej OJF-ve të autorizuar ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Tiranë, pasuar diferenca e tyre nga ato të vendosura në qytetet e Durrësit, Elbasanit, Shkodrës, Vlorës dhe Beratit. Nga raportimet e përcjella pranë DNJF, OJF-të trajtojnë mesatarisht 10 -15 raste në ditë. Përfaqësuesit e disa prej OJF-ve të intervistuar, ngritën si mungesë nevojën për përshtatjen e formave të raportimit, me synim regjistrimin e rasteve të trajtuara ligjërisht prej tyre në rrugë telefonike ose online, si dhe ankesat e adresuara kolektivisht. KShH mirëkupton njëherazi shqetësimin e DNJF dhe MD për vështirësinë që mund të hasin OJF-të në provueshmërinë e rasteve të suportuara ligjërisht online apo në rrugë telefonike. Megjithatë, KShH vëren se edhe pse është më pak e mundur të provohet plotësimi i kriterëve dhe ofrimi i shërbimit të NJF përmes telefonit apo online, numri i rasteve të raportuara është më i ulët se sa numri i rasteve që OJF-të asistojnë në praktikë, e si rrjedhojë praktika duhet përshtatur për të garantuar objektivisht shërbimin e ofruar.

Nga bashkëbisedimi me disa prej OJF-ve të intervistuar u ngrit si shqetësim burokracia që e shoqëronte procesin e kërimit të autorizimit nga ana e MD për të ofruar shërbime ligjore falas. Gjithashtu, periudha 2 vjeçare e vlefshmërisë së autorizimit konsiderohet e shkurtër, në raport me ciklin e dokumentacionit që duhet të ripërsëritet nga aktorët joqeveritarë. KShH sugjeron marrjen e masave konkrete për adresimin e këtyre problematikave nëpërmjet konsultimit periodik me aktorët e sektorit të shoqërisë civile, interesat legjitimë të të cilëve preken nga këto akte rregullatorë dhe procedurale.

Përgjithësisht, OJF-të ofrojnë shërbime ligjore falas me mbështetjen financiare të komunitetit donatorëve. Lidhur me fondet buxhetore shtetërore, përfaqësuesit e organizatave i vlerësojnë ato si të papërfillshme në raport me shërbimet që ofrohen në terren ndaj qytetarëve në nevojë. Ndër shkaqet kryesore të skualifikimit të disa prej OJF-ve radhiten: mosplotësimi i kriterëve financiarë ose zbatimi i njëkohshëm i projekteve të mbështetura nga donatorët me fokus ndihmën juridike falas.

Të dhënat e vëna në dispozicion nga DNJF, bëjnë me dije se deri në fund të vitit 2023, DNJF ka nënshkruar 12 Marrëveshje Bashkëpunimi me Klinikat Ligjore që operojnë ranë Institucioneve të

Arsimit të Lartë në Tiranë, Vlorë, Durrës dhe Shkodër. Ligji nr. 111/2017 nuk parashikon mbështetje financiare për klinikat e ligjit në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore. Mbështetja financiare e tyre mbulohet vetëm nga IAL, për sa kohë ato trajtohen si njësi të IAL-ve.

Nga monitorimi në terren vërehet se Klinikat kryesisht janë aktive dhe të angazhuara në drejtim të zhvillimit të trajnimeve të studentëve të angazhuar pranë tyre, zhvillimit të praktikave të punës për studentët si dhe realizimit të orëve të leksioneve të hapura pranë fakulteteve. Nga ana tjetër konstatohet i munguar roli i tyre në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore, dhe raportimit të rasteve të trajtuara prej tyre.

Në përgjithësi, perceptimi i qytetarëve mbi shërbimin e ndihmës juridike parësore është relativisht pozitiv, por ka ende sfida për të adresuar, siç janë rritja e ndërgjegjësimit dhe besimit në cilësinë e shërbimit falas.



## 1. Hyrje

Aksesi në drejtësi, ndër parimet themelore të shtetit të së drejtës, garanton aksesueshmërinë e barabartë të qytetarëve në drejtësi, pavarësisht nga statusi i tyre socio-ekonomik. Një sistem i efektiv i ofrimit të ndihmës juridike parësore kontribuon në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke siguruar që individët të kenë qasje në këshillim dhe përfaqësim ligjor në rastet kur të drejtat e tyre janë të kërcënuara ose të shkelura.

Sigurimi i ofrimit të shërbimeve parësore të ndihmës juridike është thelbësor për individët dhe komunitetet e marginalizuara të shoqërisë, pasi u lejon atyre të mbrojnë interesat e tyre dhe të përfitojnë nga zhvillimi ekonomik dhe social i vendit. Sistemet e aksesueshme dhe të besueshme të drejtësisë janë thelbësore në promovimin e sundimit të ligjit dhe stabilitetit social duke u mundësuar qytetarëve që kanë nevojë të përdorin të gjitha mjetet juridike në dispozicion për të rivendosur të drejtat e tyre ose për të zgjidhur çështjet ligjore. Duke ofruar ndihmë juridike parësore, rritet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, duke demonstruar përkushtimin e shtetit për të siguruar akses të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët. Garantimi i kësaj të drejte është veçanërisht jetik për grupet e marginalizuara, duke përfshirë gratë, viktimat e dhunës dhe trafikimit, të miturit, pakicat etnike dhe individët e diskriminuar, të cilët shpesh përballen me sfida të rëndësishme në aksesin në drejtësi. Për të adresuar këtë çështje, është thelbësor krijimi i mekanizmave të posaçëm institucional dhe ofrimi i shërbimeve cilësore falas të ndihmës juridike. Masa të tilla sigurojnë që këta individë të kenë mbështetjen e nevojshme për të kapërcyer kompleksitetin ligjor dhe për të arritur akses të barabartë në çdo sferë të jetës.

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ka përcaktuar se ofruesit e këtyre shërbimeve luajnë një rol shumë të rëndësishëm në sigurimin e aksesit në drejtësi duke ofruar suport ligjor në formën e dhënies së informacionit për sistemin ligjor në Republikën e Shqipërisë, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit, këshillim ligjor, asistencë ligjore për zgjidhjen e çështjeve civile, administrative, informacion në lidhje me procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve apo çdo lloj mbështetje tjetër juridike që nuk përbën ndihmë juridike dytësore.<sup>2</sup>

Nën këtë perspektivë, ndihma juridike shërben si një instrument kritik për promovimin e aksesit në drejtësi dhe mund të shihet si një shërbim social që një shtet demokratik i garanton qytetarëve të tij. Nëpërmjet garantimit të mirëfunksionimit të skemës e aktorëve të ndihmës juridike falas, shteti mbështet parimet e drejtësisë sociale dhe demonstroi përkushtimin e tij për të mbrojtur të drejtat dhe mirëqenien e të gjithë qytetarëve të tij, veçanërisht të atyre që janë më të cenueshëm.

Nëpërmjet këtij raporti të përgatitur nga ekspertë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, paraqiten të dhëna të përpunuara në mënyrë sasore dhe cilësore, mbi funksionimin e aktorëve të ndihmës juridike parësore në 8 njësi të qeverisjes vendore përkatësisht: Bashkia Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kukës, Gjirokastrë, Elbasan dhe Korçë. Raporti analizon shkallën e realizimit dhe sfidat me të cilat janë përballur Qendrat e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore falas, klinikat e ligjit pranë universiteteve dhe organizatat që ofrojnë ndihmë juridike parësore në juridiksionin e bashkive të monitoruara. Gjithashtu, raporti analizon pjesërisht nivelin e perceptimit të qytetarëve mbi cilësinë dhe aksesin në shërbimin e ndihmës juridike parësore, në Bashkitë objekt monitorimi.

<sup>2</sup> Ligj nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, Neni 3 “Përkufizime”, pika b.

Ai përmban rekomandime në terma të përmbushjes së detyrimeve ligjore nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore në drejtim të përmirësimit të nivelit të zbatueshmërisë së ligjit për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë.

Gjetjet e raportit të monitorimit do të shërbejnë për të krijuar një panoramë të përgjithshme mbi gjendjen e zbatueshmërisë së ligjit Nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” gjatë dy viteve të njëpasnjëshme 2022-2023, vetëm në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike parësore.<sup>3</sup> Si i tillë, ky raport nuk analizon shkallën e zbatimit të ligjit në kuadër të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore. Rezultatet e këtij raporti dhe sidomos sfidat dhe problematikat që ai do të nxjerrë në pah mbi zbatimin e ligjit do të shërbejnë si pikënisje për propozimin e masave konkrete në drejtim të përmirësimit të sistemit të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore me qëllimin final për të garantuar aksesin në drejtësi të të gjithë individëve pavarësisht statusit ekonomik apo social të tyre.

### 1.1 Konteksti, metodologjia dhe qëllimi i monitorimit

Ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore falas rregullohet nga ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”<sup>4</sup>, i cili u miratua në vitin 2017, si pjesë e paketës ligjore të Reformës në Drejtësi. Ky ligj shfuqizoi ligjin e mëparshëm nr.10039/2008, duke ofruar një qasje të re ndaj aksesit në drejtësi të grupeve vulnerabël. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.111/2017 mekanizmi i aksesit në drejtësi dhe ofrimit të ndihmës juridike falas u bë i mundur jo vetëm për grupet që janë të dobëta ekonomikisht, por edhe për të gjithë subjektet që mund të konsiderohen vulnerabël për shkak të statusit të veçantë social që ata kanë në shoqëri e për të cilët duhet të ketë vëmendje të shtuar të autoriteteve për t'i garantuar akses efektiv në drejtësi.<sup>5</sup>

Ligji nr.111/2017 zgjeroi rrethin e *subjekteve* dhe *objektit* të ndihmës juridike falas<sup>6</sup>. Ai krijoi një pasqyrë të funksionimit të sistemit të ndihmës juridike duke përcaktuar qartë misionin, qëllimet, parimet dhe detyrat të cilat do të ndiqen nga organet kompetente të caktuara për të garantuar ofrimin e ndihmës juridike. Ky ligj përcaktoi format, kushtet, procedurën dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të individit dhe të interesave të ligjshëm të tij.

Ligji parashikon qendrat e ofrimit të ndihmës juridike parësore, të cilat janë njësi të specializuara për dhënien e ndihmës juridike parësore dhe që e ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike përmes punonjësve me trajnim të posaçëm. Në të njëjtën kohë, referuar ligjit, ndihma juridike parësore mund të ofrohet edhe nga organizatat jofitimprurëse në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Së fundmi, ligji nr.111/2017 parashikon si subjekte të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore klinikat ligjore të ngritura pranë institucioneve të arsimit të lartë.

Duke marrë në konsideratë qëllimin që ka ligji nr.111/2017, ky raport merr përsipër të ofrojë një vlerësim të qartë dhe të detajuar të zbatimit të tij, si dhe të kontribuojë në forcimin e sistemit të

<sup>3</sup> Ky është raporti i dytë i monitorimit i hartuar nga KShH lidhur me zbatimin e ligjit nr.111/2017, pas atij të hartuar në 2020. Si i tillë ai merr në konsideratë edhe nivelin e trajtimit të problematikave dhe adresimin e rekomandimeve të sugjeruara nga KSHH në raportin e monitorimit të 2020.

<sup>4</sup>Në vijim ligji 111/2017.

<sup>5</sup>Raport pas vizitës së Komisionerit në Shqipëri 21-25 Maj 2018, (<http://ëëë.parlament.al/Projektligje/Indexlist>).

<sup>6</sup>Rishtë që përcjell ligji 111/2017, do të parashtrohen, në mënyrë të koncentruar në vijim të këtij artikulli.

ndihmës juridike parësore në vend. Në mënyrë të përmbledhur si objektiva të raportit të monitorimit mund të përmendim:

- a) Të vlerësojë nëse zbatimi i dispozitave të Ligjit Nr. 111/2017, të cilat e shtrijnë fushëveprimin vetëm mbi formën e ndihmës juridike parësore, është në përputhje me dispozitat dhe standardet e përcaktuara në ligj.
- b) Të analizojë nëse individët që kanë nevojë për ndihmë juridike parësore kanë qasje të mjaftueshme dhe të barabartë në këto shërbime, duke përfshirë grupet e cenueshme dhe të marginalizuara.
- c) Të vlerësojë cilësinë e shërbimeve të ndihmës juridike parësore që ofrohen, duke përfshirë ekspertizën dhe profesionalizmin e ofruesve të këtyre shërbimeve.
- d) Të identifikojë sfidat dhe pengesat që hasen në zbatimin e ligjit dhe ofrimin e ndihmës juridike parësore, siç janë mungesa e burimeve, infrastruktura e pamjaftueshme, ose mungesa e njohurive ligjore në popullatë.
- e) Të ofrojë rekomandime bazuar në gjetjet e raportit për të përmirësuar zbatimin e Ligjit Nr. 111/2017 dhe efektivitetin e sistemit të ndihmës juridike parësore në Shqipëri.

## 1.2 Kujt i drejtohet raporti i monitorimit?

Ky raport monitorimi dhe gjetjet e evidentuara në të do t'i shërbejnë:

- Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas si autoritetet kryesore përgjegjëse mbikëqyrëse të zbatimit të ligjit dhe ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore;
- Organizatave joqeveritare dhe aktorëve të shoqërisë civile që kontribuojnë aktivisht në fushën e drejtësisë dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, e që mbështesin reformat në sektorin e drejtësisë, për t'i informuar mbi përparimet dhe sfidat;
- Institucioneve akademike dhe qendrave të kërkimit që studiojnë sistemin e drejtësisë dhe politikat sociale, për të ndihmuar në analizat dhe studimet e tyre;
- Përfituesve të mundshëm dhe publikut e gjerë për t'i informuar mbi disponueshmërinë dhe cilësinë e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe për të rritur transparencën dhe llogaridhënien e ofruesve të këtij shërbimi.

## 1.3 Metodologjia për hartimin e raporti të monitorimit:

Hartimi i raportit të monitorimit është bazuar në një qasje të strukturuar që përfshin mbledhjen dhe analizën e të dhënave parësore dhe dytësore. Fillimisht, është konsultuar kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, duke përfshirë analizimin e ligjit nr. 111/2017 dhe aktet përkatëse nënligjore, e ato rregullatore të dala në zbatim të tij, me synim identifikimin e detyrimeve të ofruesve të ndihmës juridike parësore. Kompetencat ligjore janë përkthyer në indikatorë udhëzues për përmbajtjen e pyetësorëve të monitorimit. Procesit të intervistimit të ndërmarrë nga rrjeti i korrespondentëve dhe aktivistëve lokalë të KShH-së i janë nënshtruar qendrat e NJP, klinikat e ligjit dhe organizatat që ofrojnë NJP. Ndërkohë, pyetësorë të dedikuar u realizuan me përfshirjen e disa qytetarëve për të matur perceptimin e tyre mbi aksesin në drejtësi dhe cilësinë e shërbimit të ofruar nga ana e aktorëve të ndihmës juridike parësore.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti monitorimi u konsultuan në një tryezë të përbashkët me aktorë të përfshirë në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore.

## 1.4 Kufizime të raportit

*Së pari*, ky raport merr përsipër të analizojë të dhënat mbi nivelin e zbatueshmërisë së ligjit nr.111/2017 “Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti” vetëm në 8 bashkitë e përzgjedhura nga KShH, e më konkretisht Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kukës, Gjirokastrë, Elbasan dhe Korçë. Si i tillë, ky raport nuk merr përsipër të analizojë shkallën e zbatimit të ligjit nr.111/2017 në të gjitha Qendrat e Ndhimës Juridike Parësore të ngritura në shkallë vendi dhe gjetjet e tij nuk mund të interpretohen në mënyrë të zgjeruar edhe për ofruesit e tjerë të shërbimit të cilët nuk kanë qenë në fokus të monitorimit.

*Së dyti*, referuar shtrirjes së periudhës së monitorimit, raporti përmban analizën mbi rezultatet e monitorimit të zbatimit të ligjit nr.111/2017 vetëm për periudhën Janar 2022 – Dhjetor 2023.

*Së treti*, referuar kuadrin ligjor në fuqi, brenda nocionit të ndihmës juridike përfshihen si ndihma juridike parësore, ashtu edhe ndihma juridike dytësore. Megjithatë, për shkak të qëllimit që ka ky raport, në përmbajtjen e tij nuk analizohen gjetje lidhur me zbatimin e ligjit nr.111/2017 në terma të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore.

Pavarësisht se raporti fokusohet në monitorimin e zbatimit të ligjit nr.111/2017 nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore, për shkak të rolit dhe ndikimit që ka Drejtoria e Ndhimës Juridike, në raport përfshihen edhe të dhënat e mbledhura nga takimet e zhvilluara pranë këtij institucioni të rëndësishëm.

Gjithashtu, nisur nga fakti se pjesa më e madhe e organizatave jofitimprurëse të autorizuar nga MD kanë qendër në Tiranë (e cila nuk është përfshirë në monitorim), me qëllim grumbullimin e informacionit në mënyrë gjithëpërfshirëse, u konsiderua me rëndësi përfshirja në procesin e monitorimit edhe e OJF-ve të autorizuar nga MD me qendër në Tiranë.

## II. Rezultatet e monitorimit të ofrimit të shërbimit të Ndhimës Juridike Parësore nga Qendrat e Ndhimës Juridike Falas

### 2.1 Mbi strukturën organizative dhe logjistike të Qendrave të Ndhimës Juridike Falas

Nëpërmjet Ligjit nr.111/2017 është parashikuar se ofrimi i shërbimit të NJP realizohet nga punonjësit me trajnim të posaçëm që ushtrojnë veprimtarinë e tyre pranë Qendrave të Ndhimës Juridike.<sup>7</sup>

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas, deri në fund të vitit 2023, në rang vendi *administrohen 20 (njëzetë) qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore si vijon: 8 (tetë) qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore financohen nga UNDP/ADC në qytetin e Lezhës, Pogradecit, Vlorës, Dibrës, Kukësit, Korçës, Beratit dhe Elbasanit, kurse 12 (dymbëdhjetë) qendra si: Tirana, Lushnja, Durrësi, Shkodra, Tropoja, Përmeti, Puka, Mati, Kavaja, Kurbin, Gjirokastra dhe Fieri (financohen nga buxheti i shtetit). Vetëm gjatë vitit 2023, në mbështetje të Urdhërit të Ministrit të Drejtësisë nr. 310, datë 02.05.2023 “Për miratimin dhe kalimin nën administrimin e Drejtorisë së Ndhimës Juridike Falas të Qendrave të Shërbimit të Ndhimës Juridike Parësore Tropojë, Mat, Pukë, Kurbin, Kavajë, Përmet”, u*

<sup>7</sup> Neni 14 i ligjit nr. 111/2017

miratua hapja e 6 (gjashtë) Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore me mbështetje nga buxheti i shtetit. Në këto Qendra ushtrojnë funksionin 27 punonjës me trajnim të posaçëm.

Referuar Qendrave të NJF të monitoruara rezulton se në 5(pesë)<sup>8</sup> nga 8(tetë) qendra, numri i punonjësve të emëruar pranë qendrave është 1(një). Nga informacioni i marrë nga DNJF konstatohet se në momentin kur secila nga këto qendra është hapur, kanë qenë të punësuar 2(dy) punonjës pranë secilës qendër, të cilët kanë qenë të financuar nga UNDP/PNUD. Reduktimi i numrit të punonjësve ka ndodhur pas kalimit të këtyre qendrave nën administrimin e MD për shkak të buxhetit të kufizuar të shtetit lidhur me këtë shërbim. Gjatë takimeve me përfaqësuesit e Qendrave të NJF është konstatuar se ky reduktim ka sjellë vështirësi kryesisht lidhur me rritjen e ngarkesës së punonjësit të QNJF, zgjatjen e proceseve të ofrimit të shërbimit të NJF, por gjithashtu edhe në drejtim të kufizimit të zhvillimit të fushatave të ndërjegjësimit apo sesioneve informuese nga Qendrat për NJF. Sipas punonjësve të këtyre qendrave, është e vështirë që 1(një) punonjës i vetëm të kryejë në të njëjtën periudhë kohore edhe ofrimin e shërbimit të NJF, edhe informimin e qytetarëve mbi shërbimin e NJF.

Marrë shkas nga informacioni i sipërcituar, KShH vlerëson pozitivisht se mazhoranca e QNJF të ngritura janë të mbështetura financiarisht nga ana e buxhetit të shtetit. Nga ana tjetër, vlerësojmë se reduktimi i numrit të punonjësve të QNJF duhet të trajtohet në mënyrë analitike sa i përket efekteve që passjell në ofrimin cilësor të shërbimeve ndaj qytetarëve. Vizioni që përfaqësues të DNJF kanë mbi plotësimin e këtyre qendrave me të paktën 2 punonjës me trajnim të posaçëm, vlerësojmë se duhet të shoqërohet me planifikim konkret dhe objektiv në terma buxhetorë dhe kohorë.

Në lidhje me aksesueshmërinë e Qendrave të NJF, nga monitorimi në terren u evidentua se përgjithësisht ato ishin vendosur pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. KShH çmon se afërsia me instancat gjyqësore është pozitive në terma të aksesit në drejtësi të qytetarëve, sidomos referuar kategorive vulnerabël që ndërsa përballen me probleme ligjore, mund të këshillohen nga përfaqësuesit e këtyre organizmave për zgjidhjen e këtyre problemeve. Përfundimisht vetëm në 3 (raste)<sup>9</sup>, qendrat ishin vendosur jashtë godinave të gjykatave, konkretisht pranë Bashkisë, Këshillit të Qarkut dhe Pallatit të Sportit. M gjith, edhe në këto raste, është pozitiv fakti i lokalizimit të tyre në katin e parë të godinave, lehtësisht të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar.

Përgjithësisht qendrat janë lehtësisht të identifikueshme përmes tabelave të vendosura në ambjentet jashtë tyre, me përjashtim të asaj të ngritur në qytetin e Fierit. Kjo e fundit ndodhet brenda ambjenteve të Këshillit të Qarkut dhe mungesa e tabelës identifikuese pranohet të jetë e lidhur me mungesën e tabelës identifikuese edhe për Këshillin e Qarkut, me qëllim që qytetarët të mos krijojnë përshtypjen e gabuar që në ato mjedise ofrohet vetëm shërbimi i ndihmës juridike falas. Në vlerësimin e KShH-së, marrë shkas që kjo mungesë mund të ndikojë në kufizimin e aksesit në shërbimin e NJF të kategorive vulnerabël, konsiderohet e nevojshme marrja e masave për forcimin e dialogut midis pushtetit lokal dhe QNJF me qëllim garantimin e transparencës

---

<sup>8</sup> Korçë, Fier, Gjirokastrë, Durrës

<sup>9</sup> Vlorë, Fier, Gjirokastrë

kundrejt publikut, nëpërmjet vendosjes së tabelave identifikuese të individualizuara sipas institucioneve.

KShH nxit marrjen e masave nga ana e MD dhe DNJF për përshtatjen e formularëve të ndihmës juridike parësore ndaj qytetarëve me aftësi të kufizuar në shikim, ndërkohë që ëvshtrësitet e atyre që nuk dëgjojnë thellohen në momentin e paraqitjes së tyre pranë qendrave në mungesë të një kujdestari apo personi që mund të ofrojë asistencë mbi përdorimin e gjuhës së shenjave. Konsiderohet e nevojshme edhe prania e ndërmjetësve kulturorë, sidomos referuar ofrimit të shërbimit për kategoritë vulnerabël pjesë e komunitetit rom apo egjiptian.

Përgjithësisht u vu re se Qendrat ishin të vendosura në ambiente të përshtatshme logjistike, me përjashtim të Qendrës Fier e cila ofronte shërbimin e veprimtarinë e saj në të njëjtin ambient me Zyrën Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në vlerësimin e vetë DNJF, një situatë e tillë nuk konsiderohet problematike, në kushtet kur midis të dy institucioneve ka marrëveshje bashkëpunimi. Praktikisht, përfaqësuesi i NJF dhe KMD bashkëpunojnë me njëri – tjetrin me qëllim garantimin e parimit të konfidencialitetit, duke i ofruar qytetarëve ambiente të dedikuara e sillën e mbledhjes në rastin e trajtimit të kërkesave e ankesave. Megjithatë, duke marrë në konsideratë garantimin e standardeve të ofrimit të shërbimit të ndihmës ligjore falas, KShH vlerëson të nevojshme vendosjen e këtyre dy zyrave në mjedise të ndryshme nga njëri-tjetri.

Në terma të buxhetit, punonjësit e Qendrave të NJF nuk kishin informacion nëse MD parashikonte për çdo vit financiar shpenzime buxhetore të ndara për secilën prej qendrave. Si rrjedhojë, ata e nuk identifikonin dot trendin që kishte pësuar buxheti për shërbimin e NJF gjatë periudhës së monitorimit. Një nga nevojat e identifikuar nga ana e tyre ishte rritja e buxhetit për realizimin e fushatave të ndërgjegjësimit në të gjitha njësitë administrative nën juridiksionin e bashkisë. Në kushtet e buxhetit të kufizuar, ishte e pamundur shtrirja e fushatave të informimit dhe/ose ndërgjegjësimit të komunitetit edhe në zonat më të largëta/thella rurale.

Nga informacioni i marrë nga ana e DNJF-së rezulton se buxheti i parashikuar nga MD për shërbimin e NJF nuk është i ndarë për secilën prej Qendrave, por ai administrohet në total. Në terma krahasimore, gjatë viteve 2022-2024 ka një tendencë në rritje të buxhetit të planifikuar nga MD për shërbimin e NJF<sup>10</sup>. Megjithatë, pavarësisht kësaj rritje, pesha që buxheti i planifikuar për NJF zë në buxhetin total të MD vazhdon të mbetet më pak se 1%.<sup>11</sup> KShH vlerëson pozitivisht masat e marra nga MD e DNJF për planifikimin në terma buxhetore të fondeve të dedikuara për ofrimin e shërbimit të NJF për gratë dhe vajzat në nevojë, ndërkohë që konsideron të nevojshme planifikimin e fondeve buxhetore të veçanta edhe për kategori të tjera vulnerabël si: viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, të miturit etj. Gjithashtu, KShH sjell në vëmendje të MD nevojën për rritjen e buxhetit të planifikuar për NJF me qëllim zgjerimin e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike në të gjitha bashkitë.

---


<sup>10</sup> Më konkretisht: nga 47.200.000 lekë të planifikuar për vitin 2022, 51.232.258 lekë për vitin 2023 dhe 107.450.000 lekë planifikuar për vitin 2024

<sup>11</sup> Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës, Drejtoria e Ndihmës Juridike falas rezulton se përqindja e buxhetit të Programit të Ndihmës Juridike Falas kundrejt buxheti total të MD ka qenë: Viti 2022- 0.75%; viti 2023-0.79% dhe viti 2024 – 0.69%.

Të gjithë punonjësit e emëruar pranë qendrave të monitoruara kishin marrë trajnimin e posaçëm dhe atë vazhdues, të organizuara nga MD në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike. Forcimi i urave të bashkëpunimit dhe bashkëkoordinimit me aktorë të tjerë me impakt të rëndësishëm në fushën e NJF, si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit si edhe organizata ndërkombëtare si OSBE, UNDP/PNUD apo Këshilli i Evropës, vlerësojmë se i shërbejnë rritjes së kapaciteve të punonjësve drejt standardeve e procedurave më të mira. Krahas këtij vlerësimi mbi rolin e rëndësishëm të aktorëve të shoqërisë civile rajonale dhe ndërkombëtare, KShH do të vlerësonte konsiderimin nga ana e organizatorëve të përfshirjes në këto sesione trajnuese edhe të organizatave vendase kombëtare, të cilat kanë kontribuar në hartimin e legjislacionit të posaçëm, si dhe kanë monitoruar sistematikisht nivelin praktik të zbatueshmërisë së tij.

## 2.2 Mbi veprimtarinë e Qendrave të Ndhmës Juridike

Në zbatim të kompetencave të njohura QNJF, për ofrimin e ndihmës juridike parësore siç parashikohet në nenin 3, gërmat b- i) – b-vi) të ligjit nr. 111/2017, vlerësohet se mesatarisht punonjësit me trajnim të posaçëm pranë Qendrave raportojnë drejt DNJF trajtimin e rreth 25 rasteve në muaj




**Grafik 1: Të dhëna lidhur me Ndhmën Juridike Parësore Janar 2022-Dhjetor 2023, sipas Raporteve të publikuara nga DNJF**

Referuar të dhënave statistikore të reflektuara më sipër, KShH vëren se QNJF të vendosura pranë Bashkisë Gjirokastrë dhe Shkodër kanë trajtuar numrin më të lartë të ankesë/kërkesave ligjore të qytetarëve, përgjatë periudhës së monitorimit. Gjithashtu në Qendrat Kukës dhe Elbasan



evidentohet se ka një numër më të lartë kërkesash të pranuar nga subjekte kategori e veçantë<sup>12</sup> kundrejt subjekteve me të ardhura të pamjaftueshme.

Siç evidentohet nga grafiku më sipër, Gjirokastra dhe Shkodra janë Qendrat me numrin më të madh të rasteve të trajtuara gjatë Ndërkohë në Qendrat e tjera të monitoruara, ky raport është më i lartë në drejtim të kategorive të veçanta<sup>13</sup>. Vlerësohet pozitiv bashkëpunimi dhe ndërveprimi ndër-sektorial ndërmjet vetë Qendrave dhe DNJF, raportet e adresuara nga të cilat publikohen në faqen zyrtare të Drejtorisë, duke garantuar transparencë kundrejt çdo personi të interesuar. Përpos respektimit të afatit çdo fillim muaji për raportimin e detajuar, konstatohet se ende nuk rezulton e unifikuar procedura e raportimit prej ofruesve të shërbimeve të NJF. Në përgjithësi, të dhënat e qytetarëve administrohen nga qendrat të ndara sipas kategorisë përfituese dhe gjinisë, me përjashtim të Qendrave të vendosura pranë Bashkisë Shkodër dhe Durrës.



**Grafik nr.2 : Të dhënat mbi ndihmën juridike parësore sipas gjinisë Janar 2022-Dhjetor 2023**

Nga bashkëbisedimi me punonjësit e Qendrave dhe verifikimi i vëzhguesve në terren, u vërejt se administrimi dhe dokumentimi i të dhënave mbahet në të njëjtin regjistër si për atë të ndihmës juridike parësore dhe atë dytësore. Duke konsideruar vështirësinë që krijon ky proces në analizimin e të dhënave në një kohë të shpejtë, KShH sugjeron marrjen e masave konkrete nga ana e DNJF-së për ndryshimin e kësaj praktike dhe udhëzimin e Qendrave për administrimin e individualizuar të të dhënave në regjistra të posaçëm sipas natyrës së NJF të ofruar.

Kohëzgjatja e ofrimit të NJF parësore, nga ana e ligjvënësit është parashikuar të ofrohet menjëherë<sup>14</sup>, por në terren u vërejt se ajo varionte nga 40 minuta deri në 6 muaj, kjo e fundit e

<sup>12</sup> Neni 11 i ligjit nr. 111/2017

<sup>13</sup> Neni 12 i ligjit nr. 111/2017

<sup>14</sup> Neni 17/3 i ligjit nr. 111/2017



ndërvarur nga kompleksiteti i problematikave ligjore konkrete. Disa nga faktorët ndikues të identifikuar nga vetë punonjësit janë: natyra e çështjes, kompleksiteti i rastit që do të trajtohet, mbledhja e dokumentave të nevojshëm justifikues për përfituesit e NJP, ndërveprimi me institucione të tjera që mund të kenë lidhje me rastin konkret etj. Nisur nga digjitalizimi i një sërë shërbimeve qeveritare, KShH vlerëson pozitivisht proaktivitetin e punonjësve të Qendrave për të suportuar dhe ndihmuar qytetarët në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim.

Nisur nga natyra e çështjeve të cilat janë trajtuar më së shumti nga Qendrat rezultojnë në masën rreth 80% të jenë administrative. Diferenca i përket çështjeve me natyrë civile/familjare. Ndër rastet më të shumta të trajtuara dominonin ato për zgjidhje martesë, heqjen e zotësisë për të vepruar, caktimin e kujdestarisë, të drejtat për pension, apo të drejtat pronësore. KShH vlerëson se natyra e çështjeve duhet të shërbejë për planifikimin e objektivave të trajnimeve që realizohen nga ana e MD, në përputhje me nevojat e identifikuara.

### **2.3 Bashkëpunimi i Qendrave me organet e tjera në nivel vendor**

Për të garantuar sigurimin e aksesit të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë, dhe përfitimin e tyre nga shërbime juridike cilësore, urat e bashkëpunimit mes aktorëve pjesë e mekanizmit të ofrimit të NJF dhe institucioneve ligjzbatuese e ato të qeverisjes vendore vlerësohen të rëndësishme për t'u forcuar. Nuk janë të pakta rastet kur referimi i qytetarëve drejt qendrave realizohet nga vetë këto institucione. Paralelisht, pozitiv vlerësohet bashkëpunimi i Qendrave me OJF-të e autorizuara nga MD dhe ato në nivel lokal. Fakti që punonjësit e Qendrave nuk e ndërlidhin partneritetin e tyre me autorizimin nga e OJF-ve nga MD, mendojmë se i shërben mos krijimit të monopolizimit të ofrimit të këtyre shërbimeve, si dhe garanton gjithëpërfshirje të aktorëve në favor të interesit të komunitetit. Konsiderimi i këtij partneriteti nga të dy aktorët është vlerësuar si plotësues, dhe jo mbivendosës.

Bazuar në informacionin e marrë nga DNJF, gjatë periudhës 2022-2023 janë lidhur 28 marrëveshje bashkëpunimi midis DNJF në cilësinë e institucionit epror dhe institucioneve të tjera.<sup>15</sup> Krahas partneritetit të mirë-ngritur dhe funksional mes qendrave e disa prej institucioneve në nivel vendor, vlerësohet i munguar në raport me Zyrat Vendore të Punësimit apo Zyrat Vendore të Kadastrës. KShH e çmon me interes forcimin e marrëdhënieve ndër-institucionale midis DNJF dhe institucioneve lokale sidomos për të lehtësuar pozitën e qytetarëve në drejtim të përfitimit nga ana e tyre e shërbimit të ndihmës juridike dhe rritjes së aksesit në drejtësi për kategoritë përfituese.

### **2.4 Lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për të përfituar Ndihmën Juridike Falas**

Kuadri ligjor dhe ai nënligjor ka parashikuar një sërë procedurash e dokumentacion të posaçëm për t'u plotësuar nga individët për të përfituar shërbimin e ndihmës juridike falas. KShH vlerëson interesin e treguar nga të gjithë punonjësit e Qendrave të Ndihmës Juridike të kontaktuar për të lehtësuar pozitën e qytetarëve në drejtim të plotësimit të dokumentacionit. Vijon të konsiderohet problematikë në një pjesë të rasteve detyrimi për të provuar gjendjen e pamjaftueshme të të ardhurave ose kategorinë e veçantë ku bëjnë pjesë qytetarët. Mungesa e provueshmërisë lehtësisht mund të shndërrohet në pengesë për përfitimin e shërbimit. KShH rithekson se detyrimi i qytetarëve për të dokumentuar gjendjen e tyre vulnerabël përveç se përmes vetëdeklarimit të

<sup>15</sup> Konkretisht janë lidhur 17 marrëveshje bashkëpunimi për vitin 2022 dhe 11 marrëveshje për vitin 2023

pamjaftueshmërisë së të ardhurave apo kategorisë vulnerabël edhe me dokumentacionin e plotë justifikues e rëndon pozitën e tyre përballë aksesit në drejtësi.

Një sërë sfidash e vështirësish me të cilat përballen qytetarët janë: aksesimi i dokumentacionit përmes portalit qeveritar E-Albania, paaftësia paguese kundrejt shërbimeve/dokumentave me pagesë (psh.vërtetime negative nga Kadastra), vonesa nga institucionet publike lidhur me kthimin e përgjigjeve (psh Zyrat Vendore të Punës/Kadastrës të cilat vonojnë në kohë kthimin e përgjigjeve), apo pamundësia objektive për të mbledhur në kohë dokumentacionin e kërkuar (psh. rastet e pamundësisë për të kontaktuar me të gjithë familjarët që banojnë në vende të ndryshme, të cilët mund të jenë pjesë e tringut të familjes) për të provuar pamjaftueshmërinë e të ardhurave si anëtar i të njëjtës familjeje.

Krahas gatishmërisë së treguar nga ana e punonjësve të Qendrës për të ndihmuar qytetarët, KShH vlerëson të domosdoshme marrjen e masave konkrete nga ana e DNJF dhe MD për ndërhyrje konkrete në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, me synim lehtësimin e procesit të grumbullimit të dokumentacionit të nevojshëm nga ana e qytetarëve. Rekomandohet përshtatja e praktikave pozitive të krijuara nga disa prej institucioneve të cilat kanë vendosur ura bashkëpunimi me AKSHIN-n, kanë bërë të mundur që punonjësit e tyre të gjenerojnë të dhënat drejtpërdrejtë nga portali qeveritar. Njëkohësisht, lind nevoja për harmonizimin e legjislacionit me nismën e MD, për të mundësuar marrjen e dokumentacionit të domosdoshëm pa pagesë nga ana e portalit qeveritar, mbështetur në vulnerabilitetin e përfituesve të NJF.

Në zbatim të Udhëzimit të MD nr.2 datë 25/03.2022 “Për proceduat, periodicitetin dhe rregullat për verifikimin e rrethanave për kthimin e përfitimeve”, qytetarët duhet të plotësojnë dhe nënshkruajnë formatet e deklaratave për të njoftuar ndryshimin e rrethanave financiare/sociale ose mosndjekjen e rrugës gjyqësore për të cilën është kërkuar ndihma juridike dytësore. Në përfundim, ky proces synon kthimin vullnetar të shumave të përfituara nga ana e qytetarit, në rast të ndryshimit të pozitës ekonomike apo statusit social. Punonjësit e Qendrave bëjnë të ditur se në një pjesë të madhe, qytetarët refuzojnë nënshkrimin e tyre, duke e konsideruar sistemin e ofrimit të NJF burokratik. Duke konsideruar qëllimin madhor që qëndron pas çdo reforme ligjore dhe institucionale në sistemin e drejtësisë, KShH çmon të nevojshme zgjidhjen konkrete nga ana e DNJF dhe MD të problematikave e vështirësive të ngritura nga vetë punonjësit e Qendrave, në favor të rikthimit të besimit të qytetarëve tek drejtësia.

## **2.5 Informimi i qytetarëve mbi shërbimin e ndihmës juridike dhe rruajtja e konfidencialitetit**

Informimi i qytetarëve lidhur me shërbimin e ndihmës juridike parësore bëhet kryesisht përmes fushatave ndërgjegjësuese dhe sesioneve të informimit që Qendrat realizojnë gjatë vitit. Nga takimet e realizuara me përfaqësuesit e Qendrave u konstatua realizimi i më shumë se 500 aktiviteteve ndërgjegjësuese gjatë periudhës së monitorimit, në një masë të madhe nga qendrat në të cilat ushtrojnë funksionin 2 punonjës. Në një pjesë të rasteve, këto takime/sesione informimi janë realizuar në bashkëpunim me DNJF. Megjithatë, për shkak të buxhetit të kufizuar, shtrirja e këtyre fushatave rezulton të jetë fokusuar në zonat urbane e qendrore të Bashkive, duke pamundësuar përfshirjen në këtë proces të qytetarëve të zonave rurale dhe të thella malore.

Edhe vetë DNJF rezulton të ketë realizuar një sërë aktiviteteve informuese, për të qenë sa më pranë qytetarëve dhe komuniteteve vulnerabël të shoqërisë. Në tërësi rreth 316 aktivitete janë ndërmarrë, përgjatë viteve 2022-2023, duke synuar nxitjen dhe forcimin e bashkë-koordinimit mes mes

ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura.<sup>16</sup> Duke vlerësuar rolin e Qendrave dhe DNJF lidhur me informimin e publikut për shërbimin e NJF, KShH sjell në vëmendje nevojën për zgjerimin e hartës së aktiviteteve informuese jo vetëm në bashkitë ku janë ngritur dhe funksionojnë Qendrat, por edhe në bashki të tjera të tjera të vendit, me fokus të veçantë edhe zonat rurale dhe të thella malore.

## **2.6 E drejta për ankesë dhe vlerësimi i shërbimit nga ana e qytetarëve**

Në rast të refuzimit të ofrimit të NJF parësore ose ankesës lidhur me cilësinë e shërbimit të ofruar, ligjvënësi ka njohur të drejtën e kërkuarit për t'u ankuar pranë DNJF dhe MD. Në terma praktike, e drejta e ankimit nuk ishte përdorur në asnjërën prej qendrave të NJF të monitoruara. Qendrat rezultojnë se nuk disponojnë formularë të dedikuar vlerësimi, që mund të plotësohen në mënyrë të pavarur e të pandikuar nga ana e qytetarëve. KShH rithekson nevojën për marrjen e masave nga ana e DNJF për hartimin e formularëve tip të vlerësimit të shërbimit dhe cilësisë, që do të plotësohen nga ana e përfituesve të shërbimeve ligjore falas.

## **3.Ofrimi i shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore nga Organizatat Jofitimprurëse**

Bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 111/2017, OJF-të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë, pas përmbushjes së kriterëve të përcaktuara ligjore. Procedura për autorizimin e tyre bazohet në VKM Nr. 55, datë 6.2.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”.

Nga informacioni i marrë nga DNJF, procedura e parë e autorizimit të organizatave ka përfunduar në shtator të vitit 2020, ku janë autorizuar 12 OJF në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore. Ndërkohë, procedura e dytë e autorizimit të OJF-ve është realizuar në vitin 2023, duke sjellë një rritje me 3 OJF më shumë të autorizuar nga 19 që kishin aplikuar në këtë procedurë. Pjesa më e madhe e OJF-ve të autorizuar nga MD, e më konkretisht 10 prej tyre, ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Tiranë. Ndërkohë OJF-të e tjera janë të shtrira në Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë dhe Berat.


KShH është koshiente për rëndësinë që ka në këtë proces mirëfunksionimi i partneritetit e bashkëkoordinimi ndërmjet DNJF dhe Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kjo e fundit përgjegjëse për administrimin e regjistrit elektronik të OJF-ve. Nga informacioni i referuar nga DNJF, shumica e OJF-ve të regjistruara pranë Gjykatës, me fokus ofrimin e shërbimeve të ndihmës ligjore falas, janë të vendosura në Tiranë. KShH e çmon të rëndësishme shpërndarjen e OJF të autorizuar edhe në bashki të tjera, me qëllim shtrirjen e aksesit në drejtësi në një masë më të gjerë. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë faktin që OJF në bashki më të vogla se Tirana kanë më pak informacion lidhur me zbatueshmërinë e ligjit nr.111/2017 dhe aktet nënligjore të miratuara mbi procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për autorizim, shihet me rëndësi zgjerimi i hartës së informimit të OJF nga DNJF dhe MD në të gjithë vendin.

Procesit të intervistimit të ndërmarrë nga KShH iu nënshtruan edhe 17 OJF, nga të cilat vetëm 6 të autorizuar nga MD. Fokusi i veprimtarive të OJF-ve të intervistuar përfshinte mbrojtjen e të drejtave të grave, viktimave të dhunës në familje, ofrimin e shërbimeve riintegruese dhe rehabilituese për viktimat e dhunës dhe trafikimit, të drejtat e të rinjve, mbrojtjen e të drejtave të

<sup>16</sup> Gjatë vitit 2022, DNJF ka zhvilluar 286 takime/aktivitete ndërgjegjësuere të përbashkëta, ndërkohë gjatë vitit 2023 numërohen 30 takime/aktivitete ndërgjegjësuere të shtrira në të gjitha bashkitë.

komunitetit rom, fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave etj. Pothuajse 80% e këtyre OJF-ve e kishin pjesë të objektit të veprimtarisë së tyre edhe ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike. Megjithatë, ajo që konstatohet nga monitorimi në terren është fakti se jo të gjitha OJF-të ishin lehtësisht të aksesueshme për kategoritë në nevojë. Një pjesë e tyre i kishin zyrat pritëse në katet e larta brenda pallateve (kati i IV-V-të), ndërkohë që atyre të vendosura në katin e I-rë ju mungojnë rampet, duke krijuar vështirësi për akses të personave me aftësi të kufizuara.

Për sa i përket strukturës organizative, në masë të gjerë, Qendrat e NJF pohuan mjaftueshmërinë e stafit të tyre për të ofruar ndihmë juridike për qytetarët. Në vetëm 3 (tre) raste, OJF-të shtruan nevojën për rritjen e numrit të punonjësve të atashuar pranë Qendrave. Përgjithësisht, OJF -të rezultojnë se kanë vendosur ura bashkëpunimi efikas me DNJF kryesisht sa i përket organizimit të aktiviteteve të përbashkëta ndërgjegjësuese.



**Grafik nr. 3: Numri i rasteve të shqyrtuara nga OJF të autorizuara gjatë periudhës Janar 2022- Dhjetor 2023**

Ndër problematikat e referuara nga OJF-të e autorizuara, të përfshira në anketim, rezultojnë vështirësia e hasur në zbatueshmërinë në praktikë të udhëzimit të MD nr. 1/2019 ‘Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave’, e cila përcakton regjistrimin vetëm të rasteve që janë kontaktuar fizikisht, dhe jo atyre të këshilluara ligjërisht online ose në rrugë telefonike. Gjithashtu, në regjistër e në formatin e raportimit nga ana e OJF-ve mungon dokumentimi i rasteve kolektive. KShH sugjeron marrjen e masave nga ana e DNJF për të krijuar praktikë të unifikuar në hartimin e formateve të regjistrave dhe raporteve, që mundësojnë përfshirjen e këshillimeve ligjore të ofruara edhe në distancë, si dhe subjekteve kolektivisht.

### 3.1 Procedura e autorizimit dhe financimi i OJF nga MD

Përgjithësisht, OJF-të e përfshira në procesin e intervistimit të ndërmarrë nga KShH, e vlerësojnë procesin e pajisjes me autorizim nga MD tejet burokratik. Kriteret dhe procedurat e parashikuara

në VKM nr. 55, datë 6.2.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”, vlerësohet se kanë kosto shtesë e për përmbushjen e tyre nevojitet një kohë e dedikuar. Periudha e autorizimit nga MD, gjatë periudhës së monitorimit, rezultonte 2 vjeçare, e përceptuar e shkurtër nga ana e OJF-ve, e cila pasohej me të njëjtin cikël të ripërditësimit të dokumentacionit e realizimit të procedurës së përcjelljes së tij fizikisht në mënyrë të përsëritur në përfundim të afatit.

Me synim, shmangien e burokratizmit në terma të procesit të autorizimit të OJF-ve, KShH çmon me rëndësi nga njëra anë marrjen e masave nga ana e MD për thjeshtimin e procesit të autorizimit dhe heqjen e afatit 2 (dy) vjeçar, si dhe marrjen e masave konkrete nga DNJF për forcimin e mekanizmit të kontrollit ndaj tyre qëllim ruajtjen e cilësisë në ofrimin e ndihmës juridike parësore.

Për sa i përket financimit, OJF-të referojnë si burim kryesor të financimit donacionet e përfituara nga donatorë të ndryshëm me të cilët OJF-të bashkëpunojnë në terma projektesh. Referuar fondeve buxhetore, OJF jo vetëm që shprehen skeptike, por gjithashtu vlerësojnë se fondet shtetërore janë minimale në krahasim me shërbimin që ato ofrojnë. Referuar informacionit të ofruar nga DNJF, buxheti i miratuar për vitin 2022 dhe 2023, ka përcaktuar sipas zërit buxhetor të dedikuar për ofrimin e shërbimeve të NJF, vlerën prej 8,000,000 lekë si transferta të brendshme. Kundrejt nevojës që kanë OJF-të për përfitimin nga fondi i dedikuar në buxhetin e shtetit, vlerësohet si pengues kriteri i përcaktuar për pamundësinë e përfitimit në rast të mbështetjes financiare nga komuniteti i donatorëve.<sup>17</sup>

Nën evidentimin objektiv të mungesës së qëndrueshmërisë financiare të aktorëve të shoqërisë civile, KShH i rekomandon DNJF marrjen e masave për konsultimin e përbashkët me këta aktorë për të adresuar vështirësitë dhe pengesat të cilat kufizojnë qytetarët në përfitimin sistematik të shërbimeve të ndihmës ligjore falas që ofrohen nga OJF-të. MD vlerësojmë se mund të ushtrojnë nismën ligjvënëse për të kërkuar ndryshimin e VKM nr.110/2019, duke njohur mundësitë e bashkëfinancimit të projekteve nën këtë fokus me synim zgjerimin e fushës së veprimit të OJF-ve dhe numrit të përfituesve. Gjithashtu, KShH e vlerëson objektivisht rekomandimin e ardhur nga vetë OJF-të për nevojën e rishikimit të kuadrit nënligjor me qëllim parashikimin e mundësisë së ndarjes së fondit të planifikuar ndaj OJF-ve të autorizuara në përpjestim të drejtë me numrin e rasteve të raportuara nga ana e tyre.

Disa prej OJF të skualifikuara, renditen si arsye të skualifikimit të tyre: mosplotësimin e kriterëve financiarë apo zbatimit gjatë periudhës së aplikimit të projekteve të tjera me fokus ofrimin e ndihmës juridike falas. KShH vlerëson pozitivisht praktikën e krijuar nga MD për garantimin e parimit të transparencës dhe informimin e OJF-ve mbi këto arsye, ndërkohë që asnjëra prej tyre nuk kishte ushtruar të drejtën e ankimit, duke pranuar në thelb vendimmarrjen skualifikuese.

Amendimet ligjore që kanë prekur VKM nr.227/2023 mbi financimin e OJF-ve, janë të njohura vetëm për 4 prej OJF-ve të intervistuar. KShH e çmon me rëndësi marrjen e masave për informimin më të zgjeruar të sektorit të shoqërisë civile. Nga informacioni i përcjellë nga DNJF, për vitin 2023, 5 nga 15 OJF nuk kanë zbatuar afatet e raportimit. Përpos masave që DNJF ndërmerr për rikujtesën e tyre, në funksion të garantimit të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë,

---

<sup>17</sup> Pika 6 e vendimit nr.110/2019

KShH propozon marrjen e masave ndërgjegjësuere e informuese ndaj OJF-ve mbi detyrimet ligjore dhe sanksionet që mund të aplikohen në rast mosrespektimi të kërkesave ligjore.

### **3.2 Marrëdhënia e OJF-ve me DNJF dhe konsultimi i buxhetit vjetor për Ndhmën Juridike falas**

Bazuar në informacionin e përcjellë nga DNJF, gjatë periudhës së monitorimit rezultoi se Drejtoria ka nënshkruar 28 marrëveshje bashkëpunimi me OJF vendase dhe institucione publike në drejtim të ofrimit të shërbimeve të NJF. KShH vlerëson pozitivisht nivelin e bashkëpunimit të arritur midis DNJF dhe OJF në vend dhe rekomandon marrjen e masave për forcimin dhe rritjen e këtij partneriteti në vijimësi.

Përpos rëndësisë që merr bashkëveprimi në organizimin e aktiviteteve me fokus ndërgjegjësimin ligjor të komunitetit, KShH sugjeron mbajtjen në konsideratë të rolit të rëndësishëm që luajnë aktorët e SHC dhe përfshirjen e tyre proaktive në procesin konsultues të hartimit të buxhetor vjetor të MD dedikuar për NJF.

### **3.3 Vështirësitë lidhur me aksesin e kategorive në nevojë në shërbimet e ndihmës juridike falas**

Njëjtë si qendrat, edhe OJF-të e intervistuarat e konsiderojnë procesin e aplikimit për përfitimin nga shërbimet e NJF parësore burokratik. Edhe në arsyetimin e OJF-ve, nëse aplikantëve do t'i duhej të dokumentonin në mënyrë shteruese dokumentacionin justifikues të gjendjes së të ardhurave të pamjaftueshme dhe/ose kategorisë në nevojë ku ata bënin pjesë, nuk do të kishte kuptim që ata të nënshkruanin edhe vetëdeklarimin që i përkisnin asaj kategorie.

Konsiderohen të rëndësishme për t'u adresuar vështirësitë që hasin qytetarët në aksesin e shërbimit të ndihmës juridike nëpërmjet portalit qeveritar E-Albania, si dhe nevoja për zgjerimin e hartës së informimit të kategorive vulnerabel dhe të marginalizuara të shoqërisë mbi të drejtat e tyre, si dhe procedurat që duhen ndjekur për ofrimin e shërbimeve të NJP.

## **4. Ofrimi i shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore nga Klinikat e Ligjit në Universitete**

Roli i rëndësishëm që i është njohur klinikave ligjore të ngritura pranë institucioneve të arsimit të lartë, për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore, praktikisht vihet në zbatim vetëm përmes nënshkrimit të Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me DNJF. Nga informacioni i ofruar nga DNJF, deri në fund të vitit 2023 janë nënshkruar 12 marrëveshje, kryesisht me Klinikat që operojnë pranë Universiteteve në qytetet Tiranë, Vlorë, Durrës dhe Shkodër.<sup>1819</sup>

Duke qenë se ligjvënësi nuk ka parashikuar mbështetje financiare nga buxheti i shtetit për Klinikat e Ligjit, veprimtaria e tyre suportohet vetëm nga IAL pranë së cilës janë ngritur. Kjo formë financimi konsiderohet shqetësuese dhe jo efektive për të garantuar funksionimin efikas e në terma afatgjatë të tyre.

<sup>18</sup> 1. Fakulteti i Drejtësisë; 2. Kolegji Universitar “Ësisdom”; 3. Klinika e Ligjit Shkodër; 4. Universiteti “Aleksandër Mojsiu” Durrës; 5. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë; 6. Universiteti Europian i Tiranës; 7. Universiteti “Qirjazi”; 8. Universiteti “Bedër”; 9. Universiteti “Mesdhetar”; 10. Universiteti “Marin Barleti”; 11. Universiteti “Luarasi”; 12. Universiteti “Epoka”

<sup>19</sup> Për efekt të shtrirjes së monitorimit në këtë raport, janë zhvilluar takimet vetëm me përfaqësuesit e Klinikave të Ligjit që operojnë në bashkitë në të cilën është shtrirë monitorimi

Nëse i referohemi të dhënave statistikore të ofruara nga MD, nga të 12 Klinikat e Ligjit që operojnë në vend, gjatë vitit 2022 janë raportuar 0 (zero) raste të NJP dhe gjatë vitit 2023 janë raportuar 23 raste<sup>20</sup>. Ky trend ende i ulët, në vlerësimin e KShH-së, duhet t'i shërbejë DNJF për diskutimin e përbashkët me përfaqësues të Klinikave të vështirësive e sfidave, me synim propozimin e masave konkrete për të rivitalizuar funksionimin normal të klinikave të ligjit dhe rritur impaktin që ato mund të kenë në drejtim të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

KShH nxit marrjen e masave periodike nga ana e DNJF për përfshirjen në trajnime dhe përditësimin e njohurive të studentëve që ofrojnë shërbime ligjore parësore pranë Klinikave të Ligjit të IAL-ve. Konstatohet se për vitin 2022, DNJF ka zhvilluar trajnimet për 234 studentë të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit si dhe kanë zhvilluar praktikatat e punës 27 studentë në institucionin e DNJF dhe Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë dhe 9 studentë në Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë; Durrës dhe Shkodër.<sup>21</sup>

Për realizimin e praktikës në total shprehën interesin 27 studentë të Universitetit “Marin Barleti”; Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës; Kolegjit Universitar “Bedër”; Kolegjit Universitar “Ëisdrom”; Universitetit Europian të Tiranës; Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës; Universitetit Ismail Qemali Vlorë; Kolegjit Universitar Qiriazzi; Klinikës së Ligjit Shkodër; Universitetit “Mesdhetar”; Universitetit “Luarasi” dhe Universitetit “Epoka”, të cilët sipas një grafiku të mirëpërcaktuar patën mundësinë të angazhohen në veprimtarinë e përditshme të Qendrave dhe DNJF nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të një mentori, pjesë e stafit të Drejtorisë dhe Qendrave.

Ndërkohë, për vitin 2023, janë trajnuar nga DNJF dhe kanë realizuar praktikën 34 studentë të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit. Gjithashtu, DNJF ka zhvilluar sesionet trajnuese me temë “Aksesi në Drejtësi dhe risitë e ligjit Nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, me studentët e 12 Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve me të cilat DNJF ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

Në drejtim të bashkëpunimit me IAL-të, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, DNJF është angazhuar në kuadër të realizimit të orëve leksionesh të hapura pranë 8 fakulteteve në të gjithë vendin.

Siç edhe pranohet nga DNJF, pothuajse të gjitha Klinikat janë aktive dhe të angazhuara në drejtim të zhvillimit të trajnimeve të studentëve të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit, zhvillimit të praktikave të punës për studentët si dhe realizimit të orëve të leksioneve të hapura pranë fakulteteve. Ndërkohë që, nuk evidentohet i njëjti konstatim lidhur me ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe raportimit të rasteve të trajtuara nga ana e tyre. Në lidhje me këtë të fundit, evidentohet se vetëm disa klinika ligjore të ngritura kryesisht pranë Universiteteve jo Publike janë aktive në ofrimin e shërbimit të NJP.

Siç edhe e kemi nënvizuar prej në hyrje, për shkak të shtrirjes së kufizuar të këtij raporti, u monitoruan vetëm 2 nga 12 Klinika të Ligjit, konkretisht Klinika e Ligjit pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe Klinika e Ligjit pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan. Ndërkohë që ajo e ngritur pranë UAMD-së ishte funksionale prej vitit 2018, me

---

<sup>20</sup> Shumica e rasteve janë trajtuar nga Klinika e Universitetit “Beder” dhe “Luarasi”.

<sup>21</sup> Bazuar në Urdhërin nr. 13 datë 28.01.2022, “Për ngritjen e grupit të punës për zhvillimin e trajnimeve për studentet e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit me të cilët DNJF ka marrëveshje bashkëpunimi”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas.




mbështetjen financiare të komunitetit të donatorëve, ajo e vendosur pranë Universitetit të Elbasanit në bashkëpunim me OSBE-në pritej të fillonte aktivitetin e saj përgjatë vitit 2024.

Nga bashkëbisedimi me përfaqësuesit e të dyja klinikave, rezultojnë se funksionaliteti i tyre realizohet si pjesë e programeve mësimore (lëndë me zgjedhje), të përfshira në planin mësimor dhe jo si Njësi më vetë që të ofrojnë shërbimin e NJF brenda Universiteteve.

Për sa më sipër, mendohet e nevojshme marrja e masave nga ana e DNJF për të rritur informimin e qytetarëve mbi funksionimin e klinikave të ligjit dhe nxitja e tyre për të qenë më proaktive në drejtim të ofrimit të shërbimit ligjor parësor falas. Po kështu, KShH vlerëson të nevojshme marrjen e masave nga ana e IAL-ve për të rivitalizuar funksionimin e Klinikave të Ligjit pranë Universiteteve me qëllim që t'i rikthejnë ato në ofrues të mirëfilltë të këtyre shërbimeve, në përputhje me qëllimin e përcaktuar në ligjin nr.111/2017.

### 5. Perceptimi i qytetarëve mbi shërbimin e ndihmës juridike parësore: Gjetje të pjeshme nga pyetësorët e realizuar me disa qytetarë

Në këtë seksion të dedikuar të raportit, ka si qëllim të analizojë të dhënat e mbledhura nga zhvillimi i intervistave të anonimizuara me qytetarët që banonin në juridiksionin e bashkive të monitoruara. Intervistat u bazuan në pyetësorë të strukturuar me qëllim matjen e perceptimit të tyre lidhur me aksesin në shërbimin e ndihmës juridike parësore. Pyetësori i ndarë në dy seksione, ku të dhënat e seksionit parësor ofrojnë informacion të përgjithshëm mbi të anketuarit, dhe të seksionit pasues ofrojnë të dhëna mbi vlerësimin e shërbimit të ndihmës juridike falas.




Në tërësi u realizuan 485 intervista të ndara në 8 bashki të vendit. Siç edhe e kemi theksuar në seksionin mbi metodologjinë, lehtësuesit e KShH-së në terren u përpoqën që të kishte një ndarje të balancuar gjinore midis pjesëmarrësve në procesin e intervistave. Koncretisht, 56.5% e të intervistuarve i përkasin gjinisë femërore dhe 43.3% i përkasin asaj mashkullore.

**Grafik.nr 4: Ndarja gjinore e**

#### *pjesëmarrësve*

Në lidhje me aspektin moshor, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve 36.7% i përkasin grupmoshës 36-50 vjeç. Ndërkohë që pjesa tjetër e pjesëmarrësve ndahej si vijon: 27.6% - i përkasin grupmoshës mbi 51 vjeç, 22.1% - i përkasin grupmoshës 26-35 vjeç dhe 13.6% ishin të grupmoshës 18-25 vjeç.



**Grafik.nr 5: Ndarja e pjesëmarrësve sipas grup-moshave**




Referuar nivelit të arsimit që kishin qytetarët që pranuan të bëheshin pjesë e intervistave rezultojn se më shumë se gjysma e tyre 59.8% kishin përfunduar arsimin e mesëm. Ndërkohë që 19.2% kishin përfunduar arsimin e lartë. Vetëm 17.3% e pjesëmarrësve në pyetësor nuk kishin ndjekur asnjë shkollë arsimimi. Ndërkohë në lidhje me eksperiencën në punësim, të dhënat tregojnë se 45,2% e të intervistuarve kishin eksperiencë mbi 10 vjet në punësim, të ndjekur nga 23.1% me 5-10 vite eksperiencë, 16.1% me 1-5 vjet eksperiencë dhe 15.7% me 0-1 vit eksperiencë punësimi.



**Grafik.nr.6: Niveli i arsimit të pjesëmarrësve**    **Grafik.nr.7: Eksperiencia në punë e pjesëmarrësve**


Të pyetur në lidhje me nivelin e informimit lidhur me mundësinë e përfitimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, të dhënat tregojnë se vetëm 22.1% e qytetarëve nuk kishin dijeni mbi ekzistencën e këtij shërbimi. Ndërkohë që pjesa më e madhe e pjesëmarrësve ishin të informuar mbi ekzistencën e shërbimit të ndihmës juridike falas. Kjo e dhënë reflekton pozitivisht rolin e rëndësishëm që kanë luajtur aktorët e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike falas në zonat lokale të vendit, përfshirë ato institucionale dhe joqeveritare. Si rrjedhojë, KShH çmon me rëndësi shtrirjen e fushatave të kësaj natyre jo vetëm në zonat qendrore të Bashkive, por edhe në zonat më të thella malore/rurale, ku nevoja për ndërgjegjësim është më e madhe.



**Grafik.nr 7: Niveli i informimit të qytetarëve mbi shërbimin e ndihmës juridike falas**

Në këndvështrim të njohurive juridike, të dhënat e mbledhura tregojnë për një përqindje të konsiderueshme të qytetarëve me nivel të dobët/mesatar të njohurive juridike. 35.9% e qytetarëve kanë njohuri të dobëta juridike, ndjekur nga 30.7% të cilët e vlerësojnë nivelin e tyre të njohurive “mesatar”. Këto shifra tregojnë se qytetarët e kësaj kategori, në rast të përballjes me problematika të natyrës ligjore, do ta kenë më të nevojshme informimin apo këshillimin ligjor nga punonjës me trajnim të posaçëm apo OJF të specializuara në fushën për të cilën individët mund të kishin



probleme. Grafiku më poshtë detajon në përqindje ndarjen e qytetarëve referuar shkallës së vetëvlerësimit mbi nivelin e njohurive të tyre të përgjithshme.



**Grafik.nr.8: Shkalla e vlerësimit të nivelit të njohurive të përgjithshme juridike**


Gjithashtu, në aspektin metodologjik, lehtësuesit e KShH u kujdesën që pyetëtori t’u shpërndahej jo vetëm individëve që iu ishin drejtuar institucioneve përgjegjëse për të përfituar NJF, por edhe qytetarëve që ende nuk kishin përfituar nga ky shërbim. Konkretisht, 69.6% e të intervistuarve i ishin drejtuar të paktën një herë institucioneve shtetërore ose OJF-ve për të kërkuar ndihmë juridike. Nga këta, pothuajse 54% e përfituesve të shërbimit vlerësojnë se institucionet shtetërore/OJF i ka orientuar lidhur me procedurën që duhet të ndjekin në rastin konkret<sup>9</sup>

**Grafik. nr 9: Përqindja e qytetarëve të kanë përfituar ndihmë juridike falas**



**Grafik. Nr 10: Vlerësimi i qytetarëve nëse OJF/organet publike i kanë orientuar për procedurën që duhet të ndjekin**


momentin e intervistimit u pyetën lidhur me arsyet pse nuk ishin drejtuar deri tani për të përfituar nga ky shërbim. Të dhënat e mbledhura tregojnë se pothuajse 40% e qytetarëve nuk i ishin drejtuar shërbimit të NJF për shkak se nuk kanë pasur informacion mbi ekzistencën dhe procedurat që duhen ndjekur për aksesin në këtë shërbim. Krahasuar edhe me të dhënat më sipër, vlen të




Qytetarët që nuk kishin përfituar nga shërbimi i ndihmës juridike deri në masën më të madhe kanë njohuri mbi mundësinë për të përfituar ndihmë juridike falas, atyre iu mungojnë njohuritë specifike lidhur me ekzistencën e Qendrave apo OJF

të autorizuar me qëllim garantimin e qasjes në shërbimin e ndihmës juridike falas. Në vlerësimin e KShH-së, kjo gjetje shtron nevojën për orientimin e qytetarëve lidhur jo vetëm me përmbajtjen e ligjit në përgjithësi, por sidomos lidhur me ofruesit e shërbimit të NJF parësore dhe mundësitë për aksesimin e tyre.

Të pyetur nëse kishin përfituar nga shërbimi i NJF, pothuajse 57.5 % e të anketuarve janë shprehur se kanë përfituar të paktën një herë ndihmë juridike falas nga shteti. Pjesa tjetër e qytetarëve që nuk kishte përfituar nga ky shërbim referonte se nuk kishte dijeni mbi ekzistencën e tij, nuk ishte ndeshur me problematika ligjore, nuk kishte dijeni mbi kriteret dhe procedurat që ndiqen, ose ishin të paqartë nëse përfshiheshin kategoritë përfituese sipas ligjit. Qytetarët që kishin mundur të aksesonin shërbimin e NJF pohuan në masën mbi 70% që nuk kishte qenë e vështirë gjetja apo aksesimi pranë QNJF. Vetëm 22.5% e qytetarëve ishin përballur me vështirësi.




**Grafik nr. 12: Përqindja e qytetarëve që kanë përfituar ose jo NJF**




**Grafik nr.13: Perceptimi i qytetarëve lidhur me pyetjen nëse ka qënë apo jo e vështirë aksesimi në NJF**

Në lidhje me perceptimin e qytetarëve mbi cilësinë e shërbimit të përfituar, 41% e qytetarëve e vlerësojnë “mirë” cilësinë e shërbimit të marrë, ndjekur nga 27.4% që e vlerësojnë “shumë mirë”. Ndërkohë, vlen për t’u theksuar se të gjithë qytetarët e intervistuar mohojnë që në ndonjë rast t’i jetë kërkuar plotësimi i formularëve të vlerësimit të shërbimit pas përfitimit prej tij.




**Grafik.nr 14: Vlerësimi i qytetarëve mbi cilësinë e shërbimit të përfituar**

Nga ana tjetër vërehet një ndarje pothuajse e balancuar midis qytetarëve lidhur me perceptimin e tyre nëse do të kishin përfituar një shërbim më të mirë kundrejt pagesës. Rreth 45.6% e qytetarëve referojnë se nëse do të kishin paguar mund të kishin përfituar një shërbim më cilësor, ndërkohë që rreth 44.9% e qytetarëve mendojnë se pagesa nuk është faktor ndikues në cilësinë e shërbimit. Vetëm 9.5 % e qytetarëve të pyetur janë të vendosur se pagesa është në mënyrë absolute ndikuese. Këto të dhëna reflektojnë hezitimin e qytetarëve për të përfituar ndihmë juridike falas në momentin e përballjes me një problematikë ligjore, ndërkohë që në masë besueshmëria e tyre shfaqet më e qëndrueshme ndaj konsultimit apo përfaqësimit ligjor kundrejt pagesës.



**Grafik. Nr 15: Perceptimi i qytetarëve nëse mund të kishin përfituar një shërbim më cilësor kundrejt pagesës**

Së fundmi, nisur nga marrja e informacionit mbi ekzistencën e shërbimit të ndihmës juridike falas, të pyetur nëse do ta konsideronin të përfitonin nga ky shërbim në rast nevojë, rreth 74.5% e qytetarëve shprehen optimistë, duke pohuar se do ta konsideronin t'i referoheshin këtij sistemi në rast të problemeve ligjore. Ndërkohë, vetëm 5.6% e qytetarëve vijnë të shprehen skeptikë lidhur me përfitimin nga ky shërbim duke mohuar që do ta konsideronin për t'iu drejtuar në rast nevojë.



**Grafik.nr 16: Perceptimi i qytetarëve mbi mundësinë e përdorimit të shërbimit të NJF pas informimit**

Sa më sipër, si rezultat i të dhënave të analizuara nga pyetësorët e plotësuar me qytetarët në 8 bashki të vendit konkludohet se në përgjithësi, perceptimi i qytetarëve mbi shërbimin e ndihmës juridike parësore është relativisht pozitiv, por ka ende sfida për të adresuar, siç janë rritja e ndërgjegjësimit dhe besimit në cilësinë e shërbimit ligjor falas.

## **6. REKOMANDIME**

Bazuar në gjetjet e këtij raporti lidhur me zbatimin e ligjit nr.111/2017 “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”, KShH vlerëson se rekomandimet e mëposhtme do të ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore në vendin tonë, duke siguruar një qasje më të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët.

### ***6.1 Lidhur me ofrimin e shërbimit nga Qendrat e Ndihmës Juridike Parësore KShH:***

1. Rekomandohet marrja e masave nga ana e DNJF dhe MD për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi parashikimet ligjore në fuqi, kriteret dhe procedurat që përmbushen për të përfituar shërbime të ndihmës juridike parësore. Duke konsideruar nevojën për përfshirjen më të shtuar të komuniteteve të marginalizuara dhe atyre vulnerabël, sugjerojmë të nxitet forcimi i bashkëpunimit me aktorët qeveritarë e joqeveritarë në nivel lokal, për të realizuar aktivitete informuese në zonat rurale të vendit.
2. Rekomandohet marrja e masave nga ana e DNJF dhe ASPA për garantimin e ofrimit të trajnimit të vazhdueshëm e periodik të punonjësve të qendrave të ndihmës juridike, në fushat ligjore më relevante, në aftësitë e komunikimit dhe këshillimit për të siguruar ofrimin e një shërbimi cilësor që i përgjigjet nevojave të përfituesve.
3. Rekomandohet marrja e masave nga ana e Qendrave të ndihmës juridike falas, për të përshtatur infrastrukturën logjistike duke garantuar aksesueshmëri për të gjithë qytetarët, përfshirë personat me aftësi të kufizuara. Në raste vështirësish, nxitet roli proaktiv i Qendrave kundrejt adresimit të këtyre problematikave ndaj DNJF, me synim ndërmjetësimin për gjetjen e zgjidhjeve adekuate me pushtetin lokal.
4. Sugjerohet marrja e masave nga ana e MD dhe DNJF për alokimin e një buxheti të shtuar ndaj ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike parësore, me qëllim mbulimin e nevojave të shërbimeve dhe zgjerimin e mbulimit me shërbim në disa qytete të vendit. Me synim garantimin e realizimit të aktiviteteve në terren me fokus qytetarin, sugjerohet marrja e masave nga ana e DNJF për të mundësuar plotësimin e strukturës së Qendrave me 2 punonjës, me qëllim ofrimin e shërbimeve ligjore cilësore pa pengesa.
5. Rekomandohet forcimi i bashkëpunimit mes Qendrave të ndihmës juridike, institucioneve shtetërore, organizatave joqeveritare dhe aktorëve të tjerë për të përmirësuar koordinimin, efikasitetin e shërbimit dhe për të zgjeruar mbulimin e shërbimeve ligjore falas.
6. Rekomandohet identifikimi i zgjidhjeve dhe praktikave pozitive nga ana e DNJF, për thjeshtimin e procedurave për aplikim dhe përfitim të ndihmës juridike parësore duke mundësuar përfitimin e këtij shërbimi vetëm përmes nënshkrimit të vetëdeklarimit të statusit ekonomik apo social prej qytetarëve. Vlerësohet e domosdoshme marrja e masave nga ana e DNJF për krijimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me AKSHI-n, me qëllim ofrimin e mundësive punonjësve të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore falas për të aksesuar dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm plotësues të qytetarëve pa pagesë.

7. Në rastin e Qendrës NJF Fier, rekomandohet marrja e masave nga ana e DNJF për zhvendosjen e qendrës në një ambient të ndryshëm nga KMD, përmes bashkëpunimit me autoritetet lokale me qëllim garantimin e konfidencialitetit të të dhënave të subjekteve vulnerabël që i drejtohen Qendrës.

8. Rekomandohet hartimi nga ana e DNJF e formularëve tip të vlerësimit që do të plotësohen nga çdo qytetar që merr shërbimin në secilën qendër për të njohur problematikat, pengesat me të cilat përballen qytetarët dhe vështirësitë e tyre lidhur me marrjen e shërbimit dhe realizimin e një plani të individualizuar për çdo Qendër për të rritur cilësinë e ofrimit të shërbimit në përputhje edhe me gjetjet e formularëve të vlerësimit.

9. Rekomandohet përshtatja nga DNJF e formularëve aplikues dhe shërbimit të ofruar për personat me aftësi të kufizuara në shikim dhe dëgjim, me qëllim garantimin e aksesit të kësaj kategorie në shërbime të ndihmës juridike parësore.

### **6.2 Lidhur me ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore nga Organizatat Jofitimprurëse:**

1. Rekomandohet marrja e masave nga ana e MD dhe DNJF për rritjen e buxhetit të shtetit duke synuar zgjerimin e hartës së OJF-ve të autorizuar nga MD edhe në bashki të tjera të vendit, me qëllim shtrirjen e aksesit në drejtësi në një masë sa më të gjerë.
2. Sugjerohet përshtatja e formatit të regjistrit të raportimit të OJF nga ana e DNJF, me qëllim krijimin e mundësisë për të raportuar përmes regjistrit edhe rastet e këshilluara e trajtuara ligjërisht online e në rrugë telefonike, si dhe në formë kolektive.
3. Sugjerohet MD marrja e masave për thjeshtimin e procesit të autorizimit të OJF-ve dhe heqjen e afatit 2 vjeçar të autorizimit përmes rishikimit të VKM nr.55/2019, me synim rritjen e aksesit të OJF në procesin e marrjes së autorizimit.
4. Sugjerohet rishikimi i VKM nr.110/2019 me qëllim parashikimin e mundësive të bashkëfinancimit (publik dhe donatorë të tjera) të projekteve të ofrimit të ndihmës juridike falas, duke mundësuar rritjen e numri të OJF-ve që përfitojnë nga financimet shtetërore dhe zgjerimin e ofrimit të shërbimit të NJF. Me qëllim trajtimin e barabartë të OJF të autorizuar sugjerohet rishikimi i kuadrit nënligjor me qëllim parashikimin e mundësisë së ndarjes së fondit të planifikuar për të gjitha OJF e autorizuar në përpjestim më numrin e rasteve të raportuara nga ana e tyre.
5. Sugjerohet rishikimi i kuadrit ligjor në fuqi, me qëllim që në vlerësimin e gjendjes së pamjaftueshmërisë të merren në konsideratë jo vetëm të ardhurat/pasuritë, por edhe shpenzimet e aplikantit.

### **6.3 Lidhur me ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore nga Klinikat e Ligjit:**

1. Rekomandohet rritja e mbështetjes së Klinikave të Ligjit nga MD/DNJF, përfshirë mbështetjen financiare për të mundësuar ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe për të stimuluar zgjerimin e aktiviteteve të tyre.
2. Sugjerohet forcimi i bashkëpunimit institucional midis DNJF dhe Klinikave të Ligjit, duke përfshirë trajnimin e studentëve dhe mbështetjen në zhvillimin e praktikave të punës dhe aktiviteteve ndërgjegjëse.
3. Rekomandohet rritja e informimit dhe ndërgjegjësimin mbi Klinikat e ligjit përmes aktiviteteve ndërgjegjëse të realizuara nga DNJF për të fuqizuar njohuritë e qytetarëve mbi ekzistencën dhe rolin e Klinikave të Ligjit në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore.
4. Sugjerohet përfshirja aktive e Klinikave në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore duke trajtuar një numër më të madh rastesh dhe duke u bërë më të dukshme në komunitet.

5. Klinikat e Ligjit inkurajohen të eksplorojnë mënyra inovative për të ofruar shërbimin e ndihmës juridike parësore dhe të bashkëpunojnë me aktorë të tjerë, si organizatat joqeveritare dhe institucionet publike, për të zgjeruar ndikimin e tyre.

**Akte të konsultuara:**

- Ligji 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;
- VKM nr. 55, datë 6.2.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”;
- VKM nr. 110, datë 6.3.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”;
- Udhëzim nr. 1, datë 08.03.2019, për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave;
- Urdhër Nr.225 datë 25.3.2019 “Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”;
- Urdhër Nr.226 datë 25.3.2019 “Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”;
- Udhëzimi nr. 2 datë 25.09.2019, “për procedurat, periodicitetin dhe rregullat për verifikimin e rrethanave për kthimin e përfitimeve”;
- Urdhër nr. 531, datë 25.11.2019, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”;